

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 nga Ligji i njëjtë dhe pika 21, 22, 23 dhe 24 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve (Tekst i pastruar) nr.ark.01-2970/1 datë 5.7.2024, pika 6 dhe pika 14 të udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 datë 1.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1232/1 datë 19.3.2026, korrigjuar me nr.ark.10-1232/3 datë 3.4.2026 dhe Konkluzionin, nr.ark.02-1838/14 datë 27.4.2026, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 15-të mbajtur më 27.4.2026, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (ShTR) KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, të transmetuar më 3 mars 2026, në edicionet reprizë të programit me fjalë-diskutiv „Pastel“, në mënyrë promovuese është rekomanduar dhe i është dhënë rëndësi e tepruar (theksim ose tregim) të produkteve „ZEGIN“.

Shkelja nga paragrafi (1) të kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1232/1 datë 19.3.2026, të korrigjuar me nr.ark.10-1232/3 datë 3.4.2026, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2.URDHËROHET që ShTR KOMPANI 21-M ShPKNJ P Shkup në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

3.Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të konstatohet nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veproj sipas Aktvendimit.

4.Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditën e miratimit llogaritet dita e çertoifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në bazë të nenit 28 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LshMAAV), është kompetent të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave të Ligjit në fjalë, lejeve, certifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetues) ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur është kryer shkelje ose cënim i dispozitave të LShMAAV dhe akteve nënligjore të miratura në bazë të Ligjit të njëjtë si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Neni 55, paragrafi (2) të LSHMAA, përshkruan se programet audio dhe audiovizuele që përmbajnë plasim të produkteve ndër të tjera duhet të përmbushë dhe kushtet e mëposhtme; nuk duhet të inkurajojnë drejtpërdrejt blerjen ose marrje me qirra të mallrave ose shërbime, në veçanti përmes oferte të veçantë promovuese të mallrave dhe shërbimeve (nënparagrafi 2 i paragrafi 2 të

ligjit të njëjtë) dhe nuk duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë (theksim ose tregim) të produktit në fjalë (nënparagrafi 3 nga paragrafi 2 të Ligjit të njëjtë).

Në pikën 21 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve (në tekstin në vijim: Udhëzues) është përshkruar se programet dhe videot e krijuara nga përdorues që përmbajnë plasim të produkteve nuk duhet në mënyrë direkte të inkurajojnë konsumatorët që t'i blejnë ose t'i marrin me qira produktet ose shërbimet përmes oferte të veçantë promovuese ose promovim. Produktet ose shërbimet të cilat plasohen në programet dhe videot të krijuara nga përdorues nuk duhet t'i kushtohet rëndësi e tepruar përmes theksimit ose tregimit; në pikën 22 të Udhëzimit është parashikuar se edhe pse ndonjë produkt, markë, emër ose shenjë identifikim janë treguar në program/video, megjithatë ekspozimi ose reklamimi nuk duhet të bëhet në mënyrë jonatyrale, të tepërt ku në mënyrë të dukshme promovohet produkti, shërbimi ose marka; në pikën 23 të Udhëzimit është parashikuar se udhëheqësit/prezantuesit e programeve/videot në të cilat plasohen produkte ose shërbime duhet të mos përdorin fjalë lavdërimi për kualitetin, çmimin ose qasjen e produkteve ose shërbimeve, si dhe të shprehin vlerësime pozitive dhe rekomandime të cilat deklarojnë konsumatorët për të blerë ose marrin me qira produkte të plasura ose shërbime dhe në pikën 24 të Udhëzimit është parashikuar se vlerësimi nëse në program/video ka inkurajim direkt ose theks të tepruar të ndonjë produkti ose shërbimi, të përcaktohet në secilin rast në veçanti, në bazë të kriterëve në vijim: karakteristikat e plasimit, për shembull: hapësira e veçuar në ekran ose në studio; kohëzgjatja e shpesh të shfaqjes ose përmendjes; arsyetimin dhe qëllimin e përmendjes ose shfaqjes nga aspekti i konceptit redaktues të programit konkret/video dhe gjuhën që përdoret gjatë përmendjes, përkatësisht mjete vizuale gjatë shfaqjes.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 19 mars 2026, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) mbi shërbimet programore televizive të ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup, transmetuar më 3 mars 2026, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje e nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 të LShMAAV. Përkatësisht, në reprizat e edicionit të programit „Pastel“, pas zhanrit – program me fjalë-shou me funksion mediatik argëtues, më 3 mars 2026, është transmetuar pjesë promovuese për produktet „ZEGIN“. Janë shfaqur disa produkte dhe fokusi është vënë në pastilet FLAVO - ZINC nga kompania Solgar (fjalët e prezantueses citohen në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1232/1 datë 19.3.2026, korrigjuar me nr.ark.10-1232/3 datë 3.4.2026). Produktet e plasura rekomandohen përmes theksimit të tepërt vizual dhe verbal, që paraqet shkelje të nenit 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 të LShMAAV dhe udhëzimeve nga pikat: 21, 22, 23 dhe 24 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve të përfshira në nëntitull të përbashkët – „Ndalim i inkurajimit të drejtpërdrejtë ose theksim të tepruar“.

Shkelja e paragrafit (1) të kësaj pike është specifikuar sipas datës së shkeljes, titullit të emisionit, periudhës së transmetimit (fillimi dhe mbarim) dhe përshkrimit të shkeljes në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1232/1 datë 19.3.2026, i korrigjuar me nr.ark.10-1232/3 datë 3.4.2026, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup më 24.3.2026, dërgoi shkresë – Dorëzim i raportit me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore për deklaram nr.ark.10-1232/2 datë 24.3.2026, me të cilën iparaqiti Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1232/1 datë 19.3.2026, korrigjuar me nr.ark.10-1232/3 datë 3.4.2026, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtua këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaram me shkrim për shkeljen e dispozitave të LShMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 25.3.2026. Në afatin e parashikuar, ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të LShMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 27.4.2026, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim (të korrigjuar më 3.4.2026) konkludoi që ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup t'i shqiptoi masë – paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV, dhe në lidhje me nenin 55, paragrafi (2), nënparagrafët 2 dhe 3 nga Ligji i njëjtë dhe pikat 21, 22, 23 dhe 24 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për plasim të produkteve, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1232/1 datë 19.3.2026, korrigjuar me nr.ark.10-1232/3 datë 3.4.2026, dhe Konkluzionin nr.ark.02-1838/14 datë 27.4.2026, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LshMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 27.4.2026, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron ShTR KOMPANI 21-M ShPKNjP Shkup dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë

punën e saj me dispozitat e LShMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, veprim sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-1232/1 datë 19.3.2026, korrigjuar me nr.ark.10-1232/3 datë 3.4.2026.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për inicim të kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani